



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 12671 prot.

Tiranë, më 13.7.2021

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi

**DREJTORIVE NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE
INTEGRIMIT EUROPIAN**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 921 datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

Përgjegjës Sektori, Sektori i Mallrave të Rrezikshme, Dual Use, Trafiqueve të Paligjshme, Drejtoria e Antitrafikut, pranë Departamentit Operativ Hetimor, Kategoria B, Kategoria e Pagës III-a/1, 1 (një) vend pune

Kandidatët që do të aplikojnë duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë shtetësi shqiptare
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre
4. Të mos kenë qenë të dënuar me vendim penal të formës së prerë
5. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze
6. Të zotërojnë diplomë të nivelit Master Shkencor në Shkencat Ekonomike, Juridike, ose të lidhura me Sigurinë dhe Hetimin
7. Eksperiencë pune të paktën 3 vjet në pozicion të nivelit ekzekutiv
8. Të ketë njohuri të paktën të një gjuhe të huaj.

Avantazhe:

Të ketë njohuri në fushën doganore.

Pajisur me certifikatë sigurie nga DSIK

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

Të përgjigjet për administrimin, zbatimin e detyrave të ngarkuara nga eprorët në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të postit, si dhe respektimin e ligjit dhe konventave ndërkombëtare në kryerjen e detyrave dhe objektivave të miratuara në lidhje me linjat e më poshtme:

- a. Armët kovencionale, që përfshin armët e leta, armët e rënda të të gjitha kategorive, mjetet e blinduara, mjetet ajrore të destinuara për luftë, armët e gjahut dhe armët sportive.
- b. Armët e dëmtimit në masë që përfshin, lëndët radioaktive dhe burimeve të radiacionit (tрезатимит), armët kimike, bakteriologjike dhe lëndët plasëse.
- c. Mallrat me përdorim të dyfishtë që: të cilat përfshijnë lëndët kimike, mallrat, teknologjitë dhe paisjet në përdorimin civil, që mund të përdoren edhe për qëllime ushtarake apo terroriste.
- d. Mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet e tjera duke përfshirë, mbetjet kimike, radioaktive, bakteriologjike, biologjike, të ngurta, të lëngëta e të gjitha kategoritë e tyre, që përfshihen në katalogun shqiptar mbi mbetjet.
- e. Të lëndëve ozonholluese dhe të paisjeve që i përdorin ato.
- f. Të specieve të egra të florës e faunës të mbrojtura, të specieve të ndryshme të ndaluara të importohen në vendin tonë dhe të specieve të modifikuara gjenetikiisht.
- g. Lendeve narkotike;
- h. Barnave narkotike;
- i. Substancave psikotrope;
- j. Prekursoreve;
- k. Kontrabandimin e migrantëve;
- l. Automjeteve të vjedhura;
- m. Veprave të artit;
- n. Objekteve të trashëgimisë kulturore.
- o. Te gjitha sa me sipër, por pa u kufinuar me to, duke përdorur për transportin e tyre konteneret;
- p. Te gjitha sa me sipër, por pa u kufizuar me to, në lidhje me veprimtari të referuar apo të dyshuar terroriste, të subjekteve tregtare apo individëve, shqiptarë ose të huaj, si dhe;
- q. Zbatimin e monitorimit të masave kufizuese që lidhen me veprimtari të referuara apo të dyshuar terroriste, në mënyrë të vecante masave të përcaktuara nga Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB, në përputhje me procedurat përkatëse ligjore.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje e Diplomës dhe Lista e Notave të noterizuara (*Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njëhësi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit*)
4. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore /dëshmi penalteti
5. Vërtetim nga Gjykata

6. Vërtetim nga Prokuroria
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore
9. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Letër reference dhënë nga eprori direkt i pozicionit të fundit të punës
12. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e konkurimit do të zhvillohet në dy faza.

Në fazën parakualifikuese kandidatët do të vlerësohen nga dokumentacioni i paraqitur nëse plotësohen kërkesat për konkurim. Aplikantët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë do të vijojë me kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në:

- a) Pervojën
- b) Kualifikimin
- c) Aftësitë

Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Rezultatet e konkurimit

Lista me kandidatët fitues, do të shpallet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 23.07.2021, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/ Zyra e Sekretari/Protokollit

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Genti Gazheli

